



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

---

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tel: +355 4 2277510



# **RAPORTI VJETOR**

## **2010**

## 1. HYRJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2010 deri në 31 Dhjetor 2010.


Gjatë vitit kalendarik 2010 Agjencia e Prokurimit Publik e ka ushtruar veprimtarinë e saj në bazë të ligjit **Nr.9643, datë 20.11.2006** “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për konçesionet”, i ndryshuar, ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” si dhe në bazë të Urdhrave të Kryeministrit nr. 84, datë 10.05.2007 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe **nr.143, date 06.07.2010** “Per miratimin e struktures dhe organikes se Agjencise se Prokurimit Publik”.

Në muajin Prill 2010, me Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.257, date 23.04.2010 “Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.26, date 13.01.2010, të Keshillit të Ministrave, “Per percaktimin e numrit të punonjesve per vitin 2010, ne Ministrite dhe Institucionet Qendrore”, të ndryshuar”, pas krijimit të Komisionit të Prokurimit Publik, dhe kalimit tek ky institucion i kompetencës së shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë, është vendosur reduktimi i numrit të punonjesve të APP-se nga 36 në 18 veta.

Gjithashtu, me daljen e Urdhrit nr.89, date 23.04.2010 të Kryeministrit “Per nje ndryshim ne Urdhrin Nr.84, date 10.05.2007, të Kryeministrit, “Per miratimin e struktures dhe të organikes se Agjencise se Prokurimit Publik”, të ndryshuar”, është vendosur ndryshimi i struktures se Agjencise se Prokurimit Publik, duke shkrire Drejtorine e Shqyrtimit të Ankesave dhe Asistences Ligjore per Prokurimet, Sektorin e Inspektimit, Sektorin e Statistikes dhe Buletinit, si dhe Sektorin e Trajnimit, Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Integritimit dhe Finances, në një Drejtori të vetme të emertuar Drejtoria Juridike e Monitorimit, Publikimit, Integritimit, Trajnimit dhe Finances.

Me pas, APP-ja u ristrukturua sipas Urdhrit të Kryeministrit **nr.143, date 06.07.2010** “Per miratimin e struktures dhe organikes se Agjencise se Prokurimit Publik”.

Konkretisht, struktura e APP-së është si më poshtë:



## **2. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA**

Gjatë vitit 2010, në kuadër të Programit IPA 2008, Agjencia e Prokurimit Publik është përfituese e projektit të binjakëzimit “Mbështetje për forcimin e sistemit Shqiptar për prokurimin publik, koncesioneve dhe ankandit publik”. Qëllimi i këtij projekti, është të asistojë në arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian, sikurse janë kërkuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për fushat e lartpërmendura. Projekti filloi aplikimin në muajin Nëntor 2010 dhe do të zgjasë deri në muajin Janar 2012. Në këtë kuadër vlen të përmendet se përfitimet dhe arritjet kryesore të projektit priten gjatë vitit 2011.

Projekti është i përbërë nga tre komponentë kryesor, dhe konkretisht si më poshtë:

- I. Reforma institucionale dhe ligjore;
- II. Ngritja e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit, koncesionit dhe ankandit publik;
- III. Rritja e ndërgjegjësimit të autoriteteve kontraktore, të biznesit dhe publikut të gjerë rreth sistemit të prokurimit, koncesionit dhe ankandit publik;

Gjatë vitit 2010, APP ka marrë gjithashtu asistencë nga Banka Botërore për vlerësimin e sistemit të prokurimit elektronik dhe nxjerrjen e rekomandimeve për përmirësimin e tij të mëtejshëm. Zbatimi i këtij projekti do të shtrihet dhe gjatë vitit 2011.

Një tjetër asistencë e huaj gjatë vitit 2010 i ka ardhur Agjencisë së Prokurimit Publik në kuadër të ndryshimeve më të fundit në fushën prokurimit në sektorët utilitarë. Në këtë drejtim APP është duke u asistuar nga Projekti “Për mbështetjen e Reformës së Prokurimit Publik në Sektorët Utilitarë”. Ky Projekt financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe do të zgjasë 6 muaj. Edhe rezultatet kryesore të këtij projekti do të përfitohen gjatë vitit 2011.

### **3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2010**

#### **3.1. Ndryshimet legislative**

Per shkak te risive te sjella ne fushen legislative nga ligji Nr. 10170, datë 22.10.2009, “Per disa ndryshime në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me qellim permiresimin e legjislacionit dytesor Agjencia e Prokurimit Publik përgatiti disa amendime në rregullat e prokurimit publik, të cilat Këshilli i Ministrave i miratoi me vendimin nr.398, datë 26.05.2010. Në vijimësi të këtyre ndryshimeve, APP-ja përgatiti dhe miratoi në datë 19.07.2010

Dokumentet Standard të Tenderit ku pasqyroheshin ndryshimet përkatëse të bëra në rregullat e prokurimit publik.

Ndër ndryshimet kryesore gjatë vitit 2010 përmendim gjithashtu ndryshimet që ka pesuar ligji i prokurimit publik, sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 08.07.2010 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi menjëherë.

Ky akt normativ me fuqinë e ligjit u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10 309, datë 22.7.2010 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 8.7.2010, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ndryshimet e vendosura në këtë drejtim i përkasin kryesisht detyrave ligjore të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) në këtë fushë. Konkretisht, kompetenca e APP-së në lidhje me monitorimin e raporteve të dorëzuara nga autoritetet kontraktore, të paktën çdo 4 (katër) muaj, ka ndryshuar dhe tashmë konsiston në monitorimin e mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik, nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore dhe organit qendror blerës apo institucionit të Avokatit të Prokurimeve. Këto ndryshime përcaktojnë, gjithashtu detyrimin për miratimin e procedurave të monitorimit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë, përsa më sipër, detyrat ligjore të APP-së në lidhje me monitorimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, si dhe kryerjes së kontrolleve çdo 6 (gjashtë) muaj për procedurat e prokurimit, të ndjekura nga organi qendror blerës, janë shfuqizuar me aktin normativ të lartpërmendur.

Gjithashtu, ky akt normativ ka shfuqizuar edhe dispozitat e ligjit të prokurimit publik 9643/2006 (Nenet 65 dhe 66), përsa i përket procedurës së hetimit administrativ, si dhe veprimeve ligjore pas përfundimit të hetimit, nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Ndryshime gjatë vitit 2010 ka pësuar dhe ligji nr. 9663, date 18.12.2006 “Per koncesionet”, i ndryshuar. Ky ligj ka ndryshuar me Aktin Normativ te Keshillit te Ministrave Nr.1, date 05.05.2010 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin “Për Koncesionet”. Ky Akt Normativ, me fuqine e ligjit, u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin Nr. 10281, date 20.05.2010 “ Per miratimin e Aktit Normativ, me fuqine e ligjit, Nr.1, date 05.05.2010 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin “Për Koncesionet”. Në bazë të këtyre ndryshimeve, i kanë kaluar disa kompetenca në fushën e koncesioneve, Agjencise se Prokurimit Publik dhe Komisionit te Prokurimit Publik. Konkretisht, funksionet monitoruese i kane kaluar APP-se dhe ato te shqyrtimit te ankesave KPP-se.

Ndryshimi më i fundit ligjor gjatë vitit 2010 iu bë ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i cili u ndryshua me ligjin nr. Nr.10 346, datë 4.11.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”. Ndryshimi kryesor i këtij ligji ka të bëjë me kalimin e kompetencës së shqyrtimit të ankesave në procedurat e ankandit, nga Agjencia e Prokurimit Publik tek Komisioni i Prokurimit Publik.

### **3.2 Iniciativat nënligjore të APP-së**

Në muajin Janar e ne vijim gjate gjithe vitit 2010, për t’u ardhur sa më shumë në ndihmë palëve të përfshira në procesin e prokurimit publik me mjete elektronike (autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë), Agjencia e Prokurimit Publik hartoi Udhëzimet e detajuara si me poshte:

- *Udhezim per krijimin dhe vleresimin e dosjes se tenderit me mjete elektronike (procedura pa lote dhe procedura me lote);*
- *Udhezim per rolin e auditit;*
- *Udhezim per rolin e administratorit te autoritetit kontraktor;*

- *Udhezim Nr. 02, Date 17.05.10, “Per modifikimin e dokumentave dhe shtyrjen e afatit ne sistemin e prokurimit elektronik”;*
- *Udhezim nr. 03, Date 01.06.10, “Per shpalljen e njoftimit te kontrates, njoftimit te fituesit dhe njoftimit te kontrates se lidhur, ne sistemin e prokurimit elektronik”*

Gjithashtu në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.53, datë 21.01.2009 “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, APP hartoi dhe miratoi Udhëzimin nr. 1, datë 15.04.2010 “Për procedurat e prokurimit publik, për disa mallra dhe shërbime në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe institucioneve të varësisë nga organi qendror blerës, Ministria e Brendshme”.

Së fundi, Agjencia e Prokurimit Publik, për t’i ardhur në ndihmë të gjitha paleve të përfshira në procesin e prokurimeve ka hartuar dhe miratuar Udhëzimin N.4, datë 16.12.2010 “Për të drejtat dhe përgjegjësitë e autoriteteve kontraktore dhe institucioneve të tjera rregulluese në fushën e prokurimit publik, si APP, KPP dhe AVP”.

#### **4. SFIDAT DHE ARRITJET KRYESORE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2010**

Për realizimin me sukses të detyrave ligjore, në funksion të mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, gjatë vitit 2010, APP-ja është përballur me sfida të ndryshme që kanë kërkuar angazhimin maksimal të saj, nga të cilat më kryesoret kanë qënë zbatimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të prokurimit elektronik, për çdo procedurë prokurimi të zhvilluar nga të gjitha Autoritetet Kontraktore në Shqipëri, duke rritur kështu dhe nivelin e transparencës në procesin e prokurimit publik.

Një nga arritjet e këtij viti në fushën e prokurimit publik në përgjithësi dhe atij elektronik në veçanti, ishte marrja e çmimit të dytë në Botë, dhënë nga Kombet e Bashkuara për Shërbime Publike, në kategorinë “Përmirësimi i transparencës, përgjegjshmërisë dhe gadishmërisë në shërbimin publik”<sup>1</sup>. Lehtësirat e krijuara nga përdorimi i sistemit të prokurimit elektronik, si dhe përfitimet e arritura prej tij, janë vlerësuar nga ky çmim si një kontribut shumë i madh në përmirësimin e administratës publike në Shqipëri.

## **5. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE HOMOLOGE VENDASE DHE TË HUAJA, TË VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE.**

### **5.1. Bashkëpunimi i APP-së me institucione homologe të vendeve të rajonit dhe të BE-së**

Gjatë vitit 2010, Agjencia e Prokurimit Publik ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me institucione homologe ndërkombëtare. Në këtë kuadër përfaqësues nga Agjencia e Prokurimit Publik kanë marrë pjesë në disa takime ndërkombëtare, kanë zhvilluar vizita në disa nga vendet e rajonit dhe të BE-së si dhe kanë pritur delegacione me përfaqësues të këtyre vendeve.

Një bashkëpunim shumë të rëndësishëm gjatë këtij viti APP-ja ka pasur me Delegacionin e Komisionit Evropian në Shqipëri. Ky bashkëpunim ka konsistuar në drejtime të ndryshme në fushën e prokurimit, ku një nga drejtimet më kryesore ka qënë puna e përbashkët për fillimin e implementimit të projektit Twinning që APP përfitoi nga fondet e IPA-s 2008.

Një bashkëpunim tjetër shumë të rëndësishëm gjatë vitit 2010, APP e ka pasur me SIGMA-n (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Evropën Qendrore dhe Lindore), një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian, financuar nga BE, me përfaqësues të të

---

<sup>1</sup> <https://www.app.gov.al>



cilës ka punuar intensivisht për hartimin e ndryshimeve të legjislacionit dytësor, fokusuar kryesisht në rregullat e prokurimit në sektorët utilitarë dhe marrëveshjen kuadër. Me këtë organizëm, APP-ja ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë për hartimin e një studimi të sistemit të prokurimit në përgjithësi dhe të legjislacioneve dhe rregullave në fusha të tjera që ndikojnë në procesin e prokurimit (si psh rregullimi i financave publike, i auditit etj).

Një bashkëpunim tjetër me rëndësi, gjatë vitit 2010, APP-ja ka pasur me UNDP, e cila me kërkesën e donatorëve ndërkombëtarë që veprojnë në Shqipëri, ka financuar një vlerësim të sistemit të prokurimeve, duke dalë me një raport, ku cilësohen arritjet si dhe nevojat për përmirësim dhe rekomandimet përkatëse. Qëllimi i kësaj iniciative ishte vlerësimi i sistemit të prokurimit në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Deklarata e Parisit, sipas të cilës donatorët duhet të aplikojnë sistemin e prokurimeve të vendit në të cilin veprojnë.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka qënë një tjetër organizëm, me të cilin APP-ja ka pasur bashkëpunim shumë të mirë gjatë vitit 2010. Në kuadër të këtij bashkëpunimi ka qënë dhe një vlerësim i sistemit të rishikimit në prokurime publike, në vendet në tranzicion, ku përfshihet dhe sistemi Shqiptar i prokurimit<sup>2</sup>.

Bashkëpunim Agjencia e Prokurimit Publik gjatë këtij viti ka pasur dhe me Dhomën Amerikane të Tregtisë e cila në periudhën Shkurt-Mars 2010, me mbështetjen e Programit Prag të Koorporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II, kreu një studim<sup>3</sup> të sistemit të prokurimit elektronik (spe) në Shqipëri. Studimi u përqëndrua në aksesin në SPE për zyrtarët publikë në nivel të qeverisjes lokale dhe qendrore dhe për bizneset që marrin pjesë në tenderat publikë, si dhe në paanshmërinë, lehtësinë në përdorim, transparencën dhe efikasitetin e sistemit. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij

---

<sup>2</sup> [www.ebrd.com/lawintransition](http://www.ebrd.com/lawintransition)

<sup>3</sup> [www.amcham.com.al](http://www.amcham.com.al); <https://www.app.gov.al>;

studimi, janë një vlerësim dhe ndihmë për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit elektronik.

## **5.2. Bashkëpunimi i APP-së me institucione të tjera në Shqipëri**

Gjatë vitit 2010 Agjencia e Prokurimit Publik ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me institucione të pushtetit qendror dhe vendor brenda vendit. Një bashkëpunim të ngushtë dhe intensiv, APP-ja ka vazhduar të ketë dhe gjatë vitit 2010, me Ministrinë e Integritit. Në mënyrë periodike, në Ministrinë e Integritit është raportuar progresi që ka bërë APP-ja në drejtim të zbatimit të angazhimeve që janë marrë me nënshkrimin e MSA-së në fushën e prokurimeve publike. Me këtë Ministri janë realizuar takime të shpeshta që kanë pasur si objektiv konsultimin e specialistëve me qëllim realizimin e objektivave në fushën e integritit. Bashkëpunimi me këtë Ministri është intensifikuar në 6-mujorin e parë të vitit 2010, kur u përgatit dhe Pyetëtori i dërguar nga Bashkimi Evropian. Duke qënë se në këtë Pyetësor, kishte një kapitull të vecantë për prokurimin publik, angazhimi i APP-së dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Integritit gjatë kësaj periudhe ka qënë në nivele maksimale.

### **5.2.1. Bashkëpunimi me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Avokatin e Prokurimeve**

Gjatë vitit 2010, Agjencia e Prokurimit Publik, në ushtrimin e detyrave të saj ligjore, ka pasur bashkëpunim me institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik, i krijuar në muajin Prill të këtij viti. Në momentin e fillimit të funksionimit të këtij institucioni, APP-ja në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, i kaloi për shqyrtim KPP-së të gjitha dosjet e ankesave që ishin paraqitur pranë saj dhe ishin ende në proces shqyrtimi. Në vazhdim, me kalimin e fazës tranzitore, sipas dispozitave të legjilacionit të prokurimit publik, KPP-ja ka njoftuar APP-ne në rastet e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim që ky vendim të pasqyrohet në sistemin e prokurimit elektronik për mosprocedimin e

metejshehem nga ana e autoriteteve kontraktore. Gjithashtu, ky bashkepunim evidentohet edhe ne rastin e pasqyrimet në sistemin e prokurimit elektronik te vendimeve te dhena nga KPP-ja, ne perfundim te shqyrtimit te ankesave. Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional, dhe të rolit të saj rregullator në fushën e prokurimit publik, APP-ja ka marrë masat paraprakisht (edhe pa filluar ende të funksionojë KPP-ja), për përfshirjen e këtij institucioni në fokusin e asistencës nga disa organizma ndërkombëtar si SIGMA, EBRD dhe Projekti i Binjakëzimit, përmendur më sipër në këtë analizë.

Gjate vitit 2010, ka vazhduar bashkepunimi me Avokatin e Prokurimeve. Me gjithë ndryshimet ligjore të sipërpërmendura në drejtim të sistemit të rishikimit administrativ në prokurime, mardhëniet institucionale midis APP-së dhe Avokatit të Prokurimeve nuk kanë ndryshuar. Ky i fundit, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, vazhdon të vërë në dijeni APP-në për të gjitha hetimet administrative të nisura dhe vendimet e rekomandimet përkatëse.

Gjithsesi, duke vlerësuar frymën e bashkëpunimit, theksojmë se disa nga rekomandimet e dhëna nga Avokati i Prokurimeve, edhe gjatë vitit 2010, tejkalojnë kompetencat e tij, si dhe në disa raste, këto rekomandime janë në tejkalim të kompetencave që ligji i jep APP-së. Kështu p.sh. legjislacioni percakton APP-ne si institucionin kompetent per marrjen e masave administrative ndaj personave pergjegjes qe kane kryer shkelje te dispozitave ligjore dhe nenligjore te prokurimit publik dhe te gjitha institucionet kompetente audituese, perfshire ketu edhe KLSH-ne dergojne raportet perfundimtare te auditimit ne APP. Nderkohe, praktika e koheve te fundit ka treguar se, AVP-ja ne perfundim te hetimit administrativ te nje procedure i eshte drejtuar direkt AK-se per marrjen e masave administrative, ndonese nuk eshte nje kompetence e percaktuar ne ligj, gjë e cila mund të cojë në moskonsiderimin e tyre nga AK-të. Lidhur me këto çështje, APP-ja ka pasur komunikim të vazhdueshëm me Av.P, gjithsesi një vlerësim dhe rekomandim i kuadrit institucional në fushën e

prokurimeve, do të jetë një nga rezultatet e Projektit të Binjakëzimit që është duke asistuar aktualisht në fushë.

## **6. TREGUESIT E VEPRIMTARISË SË DREJTORIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK, GJATË VITIT 2010**

### **6.1. Tregues të veprimtarisë së Drejtorisë Juridike, Monitorimit dhe Publikimit**

Deri në muajin Prill të vitit 2010, Drejtoria ka qene e emertuar si Drejtori e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Prokurimet.

Veprimtaria e saj gjatë kësaj periudhe është fokusuar në dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë, duke konkluduar në vendimmarrjen përkatëse mbi procedurat konkrete të prokurimit apo ankandeve që kanë konsistuar këto ankesa, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin nga prokurimet publike, ankandet të shoqërive të ndryshme etj.

Gjatë periudhës në vazhdim, me ristrukturimin e APP-se, Drejtoria është emertuar si Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, dhe ndër ndryshimet më kryesore është heqja e kompetencës së shqyrtimit administrativ të ankesave, kompetence e cila tashme i ka kaluar KPP-se.

Gjatë vitit 2010 dhe kryesisht pas 4 muajit të parë të vitit, Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit e përqëndroi veprimtarinë e saj në këto drejtime kryesore:

#### **6.1.1. Ndryshimet legjislative**

Drejtorja Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, gjatë vitit 2010, ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm për përmirësimin e legjislacionit dytesor të prokurimit publik dhe

nxjerrjen e nje sere udhezimesh ne ndihme te autoriteteve kontraktore dhe operatoreve ekonomike. Në këtë kuadër, kjo drejtori gjatë vitit 2010 ka luajtur rolin kryesor në përgatitjen e vendimeve dhe udhëzimeve në fushën e prokurimit.

### **6.1.2. Shqyrtimi administrativ i ankesave deri ne muajin Prill 2010**

Një nga funksionet kryesore të kësaj drejtorie deri ne muajin prill te vitit 2010 ka qënë shqyrtimi administrativ i ankesave të operatorëve ekonomikë, të cilët, kanë patur interes apo kane ofertuar në procedura prokurimi të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore.

Nga shqyrtimi i ankesave jane konstatuar disa probleme te cilat lidhen me menyren e zbatimit te ligjit nga autoritetet kontraktore gjate perdorimit te SPE.

**Konkretisht, deri ne muajin prill te vitit 2010 janë paraqitur në total ankesa per 46 procedura prokurimi, nga të cilat:**

- **24 ankesa** kanë rezultuar **të pavlefshme**, për mosrespektim të shkallëve të ankimit, dhe/ose për paraqitje jo sipas formularit standard, apo **të pambështetura në ligj**.

-**për 4 procedura prokurimi** është marrë vendim për **modifikim** të dokumenteve të tenderit.

- **për 6 procedura prokurimi** është dhënë vendim për **anullim** procedure,

- **për 12 procedura prokurimi** është mbyllur hetimi administrativ dhe është **lejuar vazhdimi** i procedurës së prokurimit.

Pas krijimit te institucionit te Komisionit te Prokurimit Publik, si institucioni me i larte vendimmarres per shqyrtimin e ankesave, megjithe nxjerrjen e udhezimeve nga APP-ja dhe

publikimin e tyre ne internet, perseri ka vazhduar paraqitja e ankesave nga ana e operatoreve ekonomike ne Agjencine e Prokurimit Publik. Konkretisht, jane udhezuar operatoret ekonomike, te cilet kane paraqitur ankesa ne APP, ne **92 raste**.

**Ne muajin prill, e drejta e shqyrtimit te ankesave te operatoreve ekonomike, i kaloi Komisionit te Prokurimit Publik. Per kete arsye, rreth 65 praktika, ne proces shqyrtimi nga APP-ja iu transferuan ketij institucioni.**

### **6.1.3. Praktikrat e shqyrtuara per dhënie mendimesh, këshillash apo udhëzimesh**

Gjatë këtij viti, Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, në zbatim të detyrave që i ngarkon ligji nr.9643, datë 20.11.2006 „Për Prokurimin Publik“, i ndryshuar, ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë, duke konkluduar në vendimmarrjen përkatëse mbi procedurat konkrete të prokurimit dhe koncesioneve që kanë konsistuar këto ankesa (deri ne muajin Maj), dhe ankandeve (deri në muajin Dhjetor), dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin nga prokurimet publike, koncesioneve apo ankandet të shoqërive të ndryshme, etj.

Asistenca e kësaj drejtorie është përqendruar kryesisht në mirëzbatimin e rregullave të prokurimit dhe këshillimin ligjor për problemet e ndeshura gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Gjatë muajit Gusht e ne vijim, kjo drejtori ka trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash per sqarim dhe mendim nga autoritetet kontraktore, të cilat kanë konsistuar kryesisht

në mënyrën se si duhet të procedohej për procedurat e prokurimit me fonde buxhetore, të nisura në këtë muaj, në kushtet kur, me VKM-ne nr.591 date 23.07.2010 “**Për disiplinimin e përdorimit të Fondeve Buxhetore**”, u bllokuan te gjitha fondet buxhetore, te paprokuruara deri ne date 1 gusht.

Pas muajit tetor, kerkesat per sqarim kane konsistuar edhe në mënyrën se si duhet të procedohej për procedurat e prokurimit me fonde buxhetore, të nisura në këtë muaj, në kushtet kur Rregullat e Prokurimit Publik percaktojne si afat perfundimtar (perfshire edhe lidhjen e kontratave) daten 31 Tetor.

Konkretisht numri total i praktikave të paraqitura në këtë drejtori për mendim, sqarim apo informacione nga institucione te ndryshme, gjatë vitit 2010 ka qënë **245**.

Gjithashtu gjatë këtij viti kjo drejtori ka dhënë mendime dhe për projektvendime të ndryshme të iniciuara nga institucione të tjera, të cilat i janë përcjellë për mendim APP-së. Numri total i praktikave për të cilat kjo drejtori ka dhënë mendime për projektvendime të ndryshme, gjatë vitit 2010 ka qënë **21**.

#### **6.1.4. Gjobat dhe masat disiplinore**

Një nga kompetencat kryesore të kësaj Drejtorie gjatë vitit 2010, ka qënë dhe shqyrtimi i rekomandimeve të institucioneve audituese, për marrje masash në rast shkeljesh të konstatuara në procedura të ndryshme prokurimi. Në përfundim të hetimeve administrative, raporteve te derguara nga KLSH, institucionet audituese ne vend, apo Avokati i Prokurimeve nga kjo drejtori janë vendosur gjoba, si dhe janë propozuar masa ndeshkuese ndaj personave përgjegjës si më poshtë:

Masa Disiplinore: 28 raste;  
Gjoba: 14 raste;  
Tërheqje vëmendje: 2 raste;

### **6.1.5. Shqyrtimi i propozimeve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**

Një kompetencë tjetër ligjore e APP-së, që është ushtruar nëpërmjet kësaj drejtorie gjatë vitit 2010, ka qënë dhe marrja në shqyrtim e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi për një periudhë të caktuar kohore. Konkretisht gjatë vitit 2010 u morën në shqyrtim **18** propozime për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, nga të cilat në përfundim të procedimit administrativ **5** (pesë) operatorë ekonomikë janë përjashtuar nga e drejta për të marrë pjesë në prokurime. Konkretisht:

**“Brici” sh.p.k, Tirane** - përjashtohet për 1 (nje) vit (21.01.2010-21.01.2011) nga prokurimet publike

**“Klame” sh.p.k Tirane** - përjashtohet për 3 (tre) vjet (12.04.2010 -12.04.2013) nga prokurimet publike

**“Albana” sh.p.k Elbasan** - përjashtohet për 2 (dy) vjet (23.07.2010-23.07.2012) nga prokurimet publike

**“Tea D” sh.p.k Gjirokaster** - përjashtohet për 1 (nje) vit (23.12.2010-23.12.2011) nga prokurimet publike

**“Teacher & Pupils” sh.p.k Lezhe** - përjashtohet për 2 (dy) vjet (28.12.2010-28.12.2012) nga prokurimet publike.

- **9** operatorë ekonomikë nuk janë përjashtuar nga prokurimet publike pasi dokumentacioni i AK, për propozimet e tyre për përjashtimin nga prokurimet publike të këtyre shoqërive, është konsideruar i pamjaftueshëm apo nuk janë vertetuar pretendimet e propozuara për përjashtim;

-Për **4** operatorë ekonomikë procedimi administrativ për përjashtimin e tyre ka filluar dhe është ende në proces.

### **6.1.6. Shqyrtimi i ankesave në fushën e ankandeve publike.**

Nje nder detyrat, qe Ligji Nr.9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” i ngarkon APP-se ka qene shqyrtimi



administrativ i ankesave ne fushen e ankandeve publike. Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, gjate vitit 2010, deri ne muajin Dhjetor ka marrë disa ankesa, nga te cilat kane rezultuar jashte fushes se veprimtarise se APP-se **4 raste**, dhe **3 raste** kane rezultuar **te pavlefshme**.

**Me hyrjen ne fuqi te Ligjit Nr.10346, datë 04.11.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”**), e drejta e shqyrtimit te ankesave te subjekteve per procedurat e ankandit publik i ka kaluar Komisionit te Prokurimit Publik. (neni 42/1). Mbi kete baze, Drejtoria ka qene ne proces shqyrtimi te 7 praktikave, te cilat i kane kaluar per kompetence ketij institucioni.

## **7. PUBLIKIMI I BULETINIT TË NJOFTIMEVE PUBLIKE**

Ne Buletinin e Njoftimeve Publike janë botuar njoftime kontratash për procedurat e shpallura të prokurimit, njoftimet e fituesit, njoftimet e kontratave të nënshkruara, njoftimet e anulimit të procedurave të prokurimit, si dhe njoftime të tjera ku vendin kryesor e zënë njoftimet e administrates publike, si dhe njoftimet për koncesionet dhe ankandet. Gjatë vitit 2010 Agjencia e Prokurimit Publik ka publikuar në total **53** Buletine të Njoftimeve Publike që përbëjnë rreth **13. 403** faqe në total, ose mesatarisht **253** faqe për Buletin, nga të cilët janë botuar në formë të shkruar vetëm 20 Buletine (deri në datë 24.05.2010). Nga data 24.05.2010, **BNJP del vetëm në internet**, pasi me VKM nr. 398, datë datë 26.05.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, u hoq detyrimi i publikimit të Buletinit të Njoftimeve Publike, në formë të printuar.

## 7.1. Statistika në lidhje me numrin e njoftimeve të procedurave të prokurimit publik të shpallura gjatë vitit 2010

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2010, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, ne faqen zyrtare te APP-së është **4489**, nga të cilët:

### Njoftime Kontratash për vitin 2010

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te kontratave	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te kontratave	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te kontratave
Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	133	Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
Procedure negocim me shpallje paraprake	2	Procedure negocim me shpallje paraprake	3	Procedure negocim me shpallje paraprake	
E hapur Nderkombetar	4	E hapur Nderkombetar	4	E hapur Nderkombetar	1
Procedure e hapur	366	Procedure e hapur	773	Procedure e hapur	571
Kerkese me Propozim	539	Kerkese me Propozim	1403	Kerkese me Propozim	684
Procedure e kufizuar	3	Procedure e kufizuar	2	Procedure e kufizuar	
E kufizuar Nderkombetar		E kufizuar Nderkombetar		E kufizuar Nderkombetar	1
<b>TOTALI</b>	<b>1047</b>	<b>TOTALI</b>	<b>2185</b>	<b>TOTALI</b>	<b>1257</b>

Numri i njoftimeve të fituesit të publikuara është **3244**, nga të cilët:

## Njoftime Fituesish për vitin 2010

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te fituesit	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te fituesit	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te fituesit
E hapur Nderkombetar	3	E hapur Nderkombetar	1	E hapur Nderkombetar	1
Procedure e hapur	414	Procedure e hapur	1020	Procedure e hapur	299
Kerkese me Propozim	497	Kerkese me Propozim	600	Kerkese me Propozim	340
Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	69	Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
<b>TOTALI</b>	<b>983</b>	<b>TOTALI</b>	<b>1621</b>	<b>TOTALI</b>	<b>640</b>

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkruara të publikuara është **2496** nga të cilët:

## Njoftime Kontratash te nënshkruara për vitin 2010

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te kontratave te nenshkuara	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te kontratave te nenshkuara	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te kontratave te nenshkuara
E hapur Nderkombetar	2	E hapur Nderkombetar	2	E hapur Nderkombetar	1
Procedure e hapur	133	Procedure e hapur	548	Procedure e hapur	354
Kerkese me Propozim	242	Kerkese me Propozim	742	Kerkese me Propozim	407
Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	65	Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
<b>TOTALI</b>	<b>442</b>	<b>TOTALI</b>	<b>1292</b>	<b>TOTALI</b>	<b>762</b>

Gjithashtu gjatë këtij viti janë publikuar dhe 1960 Kontrata të nënshkruara për procedura me negociim pa publikim të njoftimit të kontratës.

Në mënyrë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik për vitin 2010, dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

**Numri total i procedurave të shpallura, ndarë sipas llojit të procedurave për periudhën 1 Janar 2010 - 31 Dhjetor 2010**

<b>Nr.Total i Procedurave të shpallura</b>	<b>6449</b>
<b>Fondi total limit i procedurave të shpallura</b>	<b>73,829,087,560</b>
shërbim konsulence nr	133
shërbim konsulence ne vlerë	1,597,494,414
negocim me shpallje nr	5
negocim me shpallje ne vlerë	10031333
I hapur ndërkombëtar nr	9
i hapur ndërkombëtar ne vlerë	9,530,592,018
I hapur lokal nr	1,710
I hapur lokal ne vlerë	35,387,334,782
kerkesë për propozim nr	2,626
kerkesë për propozim vlerë	6,003,098,429
I kufizuar ndërkombëtar nr	1
I kufizuar ndërkombëtar vlerë	15,416,979,585
I kufizuar lokal nr	5
I kufizuar lokal vlerë	133,318,416
negocim pa shpallje nr	1,960
negocim pa shpallje vlerë	5,750,238,583

Në mënyrë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, fondin limit përkatës, numrin e

procedurave të fituara me fondin limit dhe fondin e ofruar përkatës si dhe kursimin në %, të zhvilluara në sistemin elektronik gjatë vitit 2010 janë si më poshtë:

**Procedura prokurimi të zhvilluara në sistemin elektronik - Periudha 1 Janar 2010 - 31 Dhjetor 2010**

Nr.Total i Procedurave te shpallura	4489
Fondi total limit i proc.te shpallura	68,078,848,977
Nr.Total i Proçedurave te shpallura dhe ende ne proces	3349
Fondi total limit i proc.te shpallura dhe ende ne proces	57,814,525,123
Nr.Total i Procedurave te shpallura te anuluar	1140
Fondi total limit i proc.te shpallura te anuluar	10,264,323,854
Nr.Total i Procedurave te fituara	3244
Fondi total limit i prokuruar	26,226,331,738
Fondi total i ofruar	23,098,893,184
% qe ze Fondi i ofruar ndaj Fondit limit te prokuruar	88%
Fondi total i kursyer	3,127,438,554
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondil limit te prokuruar	12%

Në mënyrë tabelore, të dhënat për prokurimin elektronik dhe procedurat negociim pa shpallje paraprake të njoftimit si dhe raportet në % dhe fondi i kursyer për vitin 2010 janë si më poshtë:

**Prokurime elektronike dhe Procedura me Negocim pa shpallje  
paraprake të njoftimit për Periudhën 1 Janar 2010 - 31 Dhjetor  
2010**

Nr.Total i Procedurave të shpallura	6449
Fondi total limit i procedurave të shpallura	73,829,087,560
Nr.Total i Proc.të fituara elektronik	3244
Fondi total limit i prokuruar për procedurat elektronike	26,226,331,738
Fondi total i ofruar për proced elektronike	23,098,893,184
Nr.Total i Procedurave te fituara Negoc pa shpallje	1960
Fondi total limit i prokuruar negoc pa shpallje	5,750,238,583
Fondi total i ofruar negoc pa shpallje	5,640,202,135
% që zë nr i proc të fituara negoc pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara	37.6%
% që zë fondi limit i proced me negoc pa shpallje ndaj fondit limit total (elektronik + negociim pa shpallje) për procedurat e fituara	17.9%
% që zë fondi i ofruar proced me negoc pa shpallje ndaj fondit total (elektronik + negociim pa shpallje) për procedurat e fituara	19.6%
Nr.Total i Procedurave të fituara (elektronik + negociim pa shpallje)	5,204
Fondi total limit i prokuruar (elektronik + negociim pa shpallje)	31,976,570,321
Fondi total i ofruar (elektronik + negociim pa shpallje)	28,739,095,319
% që zë Fondi i ofruar ndaj Fondil limit të prokuruar	90%
Fondi total i kursyer	3,237,475,002
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondil limit të prokuruar	10%

Në mënyrë tabelore, për procedurat e prokurimit elektronik të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2010 janë si më poshtë:

**Te dhëna për procedurat e prokurimit të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2010**

Llojet e procedurave	Nr.Total i procedurave	Fondi limit total i prokuruar	Fondi total i ofruar (tenderuar)	% që zë Fondi i ofruar ndaj Fondit limit të prokuruar	Fondi total i kursyer	% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit të prokuruar
Procedurë e hapur ndërkombëtare (njoftim fituesi)	5	2,894,977,607	2,692,396,412	93%	202,581,195	7%
Procedurë e hapur (njoftim fituesi)	1733	19,328,225,699	16,998,237,390	89%	2,329,988,310	11%
Procedurë kërkesë për propozim (njoftim fituesi)	1437	3,144,050,550	2,719,477,426	86.50%	424,573,124	13.50%
Shërbim konsulence, konkurs projektimi (njoftim fituesi)	69	859,077,881	688,781,956	80%	170,295,925	20%
<b>Totali</b>	<b>3244</b>	<b>26,226,331,738</b>	<b>23,098,893,184</b>	<b>88%</b>	<b>3,127,438,554</b>	<b>12%</b>

**8. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË ANKESAVE DHE ASISTENCËS LIGJORE PËR KONÇESIONET DERI NË PRILL 2010**

Drejtorja e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Konçesionet ka punuar deri në prill të vitit 2010, në përputhje me objektivat e përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 ‘Për koncesionet’, i ndryshuar, për mbikqyrjen e zbatimit të procedurave koncesionare. Pas ristrukturimit që pesoi institucioni nepermjet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.257, datë 23.04.2010, si dhe Urdhrit nr.89, datë 23.04.2010 të Kryeministrit “Për një ndryshim në Urdhër Nr.84, datë 10.05.2007, të Kryeministrit, “Për miratimin e

struktues dhe te organikes se Agjencise se Prokurimit Publik”, te ndryshuar”, kjo Drejtori u shkri.

Ne periudhen e tremujorit te pare te vitit, kryesisht puna e kësaj drejtorie ka qenë e përqëndruar në shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomike.

Gjatë shqyrtimit administrativ, të ankesave të dërguara në APP, ka rezultuar që operatorë të ndryshëm kanë depozituar edhe ankesa të paargumentuara juridikisht ose jashtë afateve. Konkretisht, ne tre raste, kjo drejtori nuk ka bërë pezullimin e procedurës konform nenit 25/4/a të ligjit per koncesionet.

Drejtoria e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Konçesionet, në vijim të hetimit andministrativ, duke qenë se ka konstatuar disa parregullesi nga ana e Autoritetit Kontraktues, për të gjykuar sa më drejtë dhe në mënyrë të paaneshme dhe transparente ka vendosur të dergojë për rivlerësim pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, 3 procedura.

Me pas, me miratimin e Ligjit Nr. 10281, date 20.05.2010 “ Per miratimin e Aktit Normativ, me fuqine e ligjit, Nr.1, date 05.05.2010 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin “Për Koncesionet”, kompetenca e shqyrtimit te ankesave në fushën e koncesioneve, i kaluan Komisionit te Prokurimit Publik.

**Per kete arsye, hetimet administrative te nisura nga APP-ja per 3 procedurat koncesionare iu transferuan ketij institucioni.**

## **9. TREGUESIT E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT TË INSPEKTIMIT DERI NË MUAJIN MAJ 2010**

Agjencia e Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, deri në muajin Maj të vitit 2010, ka pasur kompetencë të verifikojë zbatimin e



procedurave të prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj, duke kryer kontrole në autoritetet kontraktore për procedurat e prokurimit të realizuara prej tyre si dhe/ose duke u kërkuar autoriteteve kontraktore të dorëzojnë të gjithë informacionin përkatës, për procedurat e prokurimit, objekt kontrolli. Gjithashtu një detyrë tjetër e rëndësishme për këtë Sektor ka qënë dhe shqyrtimi i rekomandimeve të dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe auditet e brendshme të institucioneve të ndryshme, për shkelje të konstatuara në procedura prokurimi. Në përfundim të shqyrtimit të këtyre raporteve, Sektori në fjalë dilte me propozim konkret mbi masat e rekomanduara, në bazë të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi. Me ndryshimet institucionale dhe strukturore të përmendura më sipër në këtë analizë, ky Sektor u shkri dhe një pjesë e kompetencave të tij i kaloi Drejtorisë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit.

## **10. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR DREJTORINË E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

Gjatë vitit 2010, Agjencia e Prokurimit Publik ka bërë përmirësime të ndjeshme në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit Elektronik në Sistemin e Prokurimeve Publike në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale të Shoqësisë së Informacionit në Shqipëri. Detyrat kryesore të Drejtorisë së IT kanë qënë:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit duke siguruar kushte sa më të mira pune për të gjithë përdoruesit online të Sistemit të Prokurimit Elektronik si dhe punonjësit e brendshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Rritja e kapaciteteve hardware veçanërisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik duke u mundësuar të gjithë përdoruesve një ambjent stabil dhe të sigurtë pune.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së Sistemit të Prokurimit Elektronik.

- Studime për zhvillimin e funksionaliteteve të sistemit për përmirësimin e pikave ku shfaqeshin pengesa brenda bazës së të dhënave, të cilat sillnin vonesa në punën e përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik.
- Monitorim i vazhdueshëm i databazës së të dhënave të Sistemit të Prokurimit Elektronik.
- Përmirësim të hapave që ndiqen në procedurat elektronike të prokurimit duke i sjellë këto të fundit sa më afër legjislacionit në fuqi.
- Bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Ministrave për rikonfigurimi e Black Box-it në ambjentet e Këshillit të Ministrave.
- Bashkëpunimi i herëpashershëm me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen kapaciteteve. Ky bashkëpunim ka rezultuar i suksesshëm në ofrimin e sigurisë për Sistemin e Prokurimit Elektronik.
- Rritja e kapaciteteve hardware për serverin që ruan backup-et në ambjentet e AKSHI-t konform madhësisë së bazës së të dhënave, në mënyrë që të rritet siguria e këtyre të dhënave.
- Studime të detajuara për ndarjen e arkivës nga baza e të dhënave operationale si dhe optimizimi i kësaj të fundit.
- Kryerja e investimeve në ambjentin fizik të dhomës së serverave si dhe blerja e pajisjeve të ndryshme si kamera, derë e blinduar, room alert, etj, për të rritur sigurinë.
- Mbështetja teknike që u jepet të gjithë Operatorëve Ekonomikë të huaj dhe vendas si dhe të gjitha Autoriteteve Kontraktore që përdorin Sistemin e Prokurimit Elektronik, nëpërmjet email-eve, telefonit apo dhe konsultimeve në ambjentet e APP, është një punë e përditshme për këtë drejtori.
- Përmirësimi i faqes zyrtare të internetit të APP-së, e cila është pasuruar me informacion të përditësuar në lidhje me procesin e prokurimit.

- Krijimi i manualeve të reja për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe për secilin rol që ata kanë në procesin e prokurimit në mënyrë që të gjitha veprimet që ata bejnë të jenë sa më mirë të sqaruara dhe të detajuara.
- Gjatë vitit 2010 Drejtoria e IT ka filluar arkivimin elektronik të procedurave të realizuara në vitin 2008 dhe 2009. Këto procedura ruhen në një server tjetër “Arkivë” me qëllim lehtësimin e bazës së të dhënave operacionale dhe cilësi më të lartë të shrbimit, si dhe rritje të shpejtësisë së gjetjes së të dhënave dhe efikasitetit në procedurat elektronike në sistemin e prokurimit publik.

Gjatë vitit 2010, Drejtoria IT ka bashkëpunuar edhe me “Procurement Intelligence Unit”, e cila është një organizatë me vendndodhje në Angli që ofron një burim të kategorizuar në dhënien e një game të gjerë shërbimesh inteligjente dhe mjete informacioni për profesionistët e prokurimeve të korporatave të ndryshme. Kjo organizatë ka realizuar një raport shumë pozitiv mbi implementimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik në Shqipëri<sup>4</sup>.



Nuk duhet harruar pa përmendur fakti që mbajtja online e Sistemit të Prokurimit Elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës përveç rasteve kur paralajmërohet me anë të një njoftimi, është një sfidë e madhe me të cilën përballet drejtoria e IT.

### **10.1. Paraqitja grafike e procedurave të prokurimit publik dhe numrit të ofertave dhe ofertuesve:**


Në diagramat e mëposhtme pasqyrohen procedurat e publikuara në faqen e APP-së, gjatë vitit 2010, krahasuar me vitin 2009:

---

<sup>4</sup> <http://www.procurement-iu.com/>




Në diagramat e mëposhtme pasqyrohen njoftimet e fituesit të publikuar në faqen e APP-së, gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009:



Numri total i ofertave në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë vitit 2010 ka qënë 21 796, nga të cilat 7 661 kanë qënë oferta të refuzuara nga Autoritetet Kontraktore. Mesatarja e ofertave për procedurë, gjatë vitit **2010 ka qënë 7 (shtatë) oferta.**

**Numri total i ofertave**



## **10.2. Përmirësimet e bëra në sistemin e prokurimit elektronik si dhe hyrja në sistem nga të interesuarit**

Gjatë vitit 2010 nga Drejtoria e IT-së janë bërë përmirësime të dukshme mbi sistemin e prokurimit.

Në periudhën Tetor 2009-Dhjetor 2009, Agjencia e Prokurimit Publik organizoi trajnime për Autoritet Kontraktore në kuadër të ndryshimeve dhe përmirësimeve të Sistemit të Prokurimit Elektronik që do të viheshin në zbatim në fillim të vitit 2010.

Në këtë kuadër, në fillim të vitit 2010 u mundësua kalimi i të drejtës së administrimit (krijimi i përdoruesve në role të ndryshme në sistem), nga APP-ja tek Autoritetet Kontraktore duke i vënë në dispozicion çdo Autoriteti Kontraktor një llogari në rolin “Administrator” ose “CA-Admin”. Me anë të kësaj llogarie përdoruesi, mund të krijohen llogaritë për anëtarët e rinj të Njesisë së Prokurimit, të Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave, të Komisionit të Shyrtimit të Ankesave dhe atë të Auditit pa qenë nevoja që këta përdorues të dërgohen me shkresë drejt APP për t’u krijuar nga kjo e fundit.

Për vitin 2010 nga Drejtoria e IT janë krijuar **1329** llogari administratori të sistemit të cilat u janë vënë në dispozicion Autoriteteve Kontraktore dhe nga këta administratorë janë krijuar **2580** llogari përdoruesi (anëtarë të Njesisë së Prokurimit, të Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave, të Komisionit të Shyrtimit të Ankesave dhe atë të Auditit, për Autoritetet Kontraktore në sistem.

Gjithashtu me anë të kësaj llogarie Autoriteti Kontraktor mund të kryejë teknikisht në sistemin e prokurimit elektronik shtyrjen e datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit në rastet e përcaktuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore të prokurimit.


Një funksion tjetër shumë i rëndësishëm i rolit të Administratorit të Sistemit është edhe caktimi në sistem i anëtarëve të Komisionit të Shyrtimit të Ankesave dhe atyre të Auditit, të cilët tashmë kanë mundësi të kryejnë në rrugë elektronike auditimin e një procedure të caktuar prokurimi. Ky funksion i shtuar në sistemin e prokurimit elektronik, ka sjellë lehtësi në përdorimin e sistemit nga Autoritetet Kontraktore si dhe evitimin e problemeve që buronin nga vonesat e komunikimit në formë shkresore.

Monitorimi i vazhdueshëm i komunikimit me databazën e QKR-së ka sjellë një kontroll më të madh mbi operatorët ekonomikë. Per vitin 2010, në sistemin e prokurimit elektronik, janë regjistruar **336** operatorë ekonomikë të rinj nga të cilët **114 janë operatore ekonomike të huaj**.


Më poshtë tregohen disa statistika të përgjithshme mbi përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik në vitin 2010:

<b>Statistika të Përgjithshme</b>	
Klikimet në total:	<b>137424534</b>
Mesatarja e klikimeve për ditë:	<b>376506</b>
Mesatarja e klikimeve për përdorues:	476
Përdoruesit në total:	288592
Mesatarja e përdoruesve për ditë:	791
Sesionet në total:	603230
Mesatarja e sesioneve për ditë:	1653
Koha totale e shpenzuar në faqe nga përdoruesit:	8153 Ditë 22:21:31
Mesatarja e kohës së shpenzuar për përdorues:	122:00:00

**Sesionet per muaj**




**Klikimet totale per muaj**






**Perdorimi sipas oreve te dites**



**Perdorimi sipas diteve te javes**



Rritja e kapaciteteve ka qenë një nga sfidat e radhës të kësaj Drejtorie. Tashmë kemi një sistem i cili e ka kaluar 1.9 TB databazë operacionale, 500 GB databazë arkivë si dhe një aplikacion i cili shpërndan ngarkesën në 3 servera të

ndryshem në mënyrë që të balancohet fluksi. Kujdesi për bazën e të dhënave ka qenë një nga detyrat e përditëshme me të cilën është përballur Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit.

Specialistët e kësaj drejtorie kanë qëndruar në gadishmëri jashtë orarit zyrtar të punës gjatë ditëve të javës si dhe gjatë fundjavës.

### **10.3.Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP-së**

Gjatë vitit 2010 Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ka punuar intensivisht për krijimin dhe përmirësimin e manualeve dhe udhëzimeve për përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik. Manualet janë shumë të detajuara duke ndjekur çdo fazë të procedurës, parë nga të gjithë rolet e përdoruesve të Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Ndihma e nevojshme sqaruese është dhënë edhe nëpërmjet email-eve, telefonit, konsultimeve dhe shkresave zyrtare nga specialistët në Drejtorinë e IT. Drejtoria e IT i përgjigjet mesatarisht në ditë rreth 45 telefonatave dhe rreth 30 emaileve që vijnë nga Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë kombëtar e ndërkombëtar.

Nuk duhet harruar pa u përmendur edhe puna e përditshme e Drejtorise se IT në suportin e vetë përdoruesve brenda APP-së si dhe në menaxhimin e infrastrukturës. Kryerja e detyrave të ngarkuara dhe bashkëpunimi me Drejtoritë e tjera ka sjellë rezultate shumë të mira.

Këtu vlen të përmendet bashkëpunimi i Drejtorisë së IT me Drejtorinë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit. Bashkëpunimi me këtë Drejtori, ka qenë gjithashtu shumë produktiv për sa i përket evidentimit të rasteve problematike dhe zgjidhjen e tyre si dhe në përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik, konform legjislacionit në fuqi.

Të gjitha detyrat dhe objektivat për vitin 2010, të cilat përfshijnë:

- Optimizimin e procesit të punës;
- Rritjen e mëtejshme të sigurisë së Sistemit të Prokurimit Elektronik;
- Krijimin e Arkivës Elektronike;
- Lehtësimin e databazës;
- Optimizimin e dokumentacionit që përdoret për Sistemin e Prokurimit Elektronik;
- Trajnimin e përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik;

janë realizuar me sukses dhe me përgjegjësi nga stafi i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit duke rritur cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimit me përgjegjshmëri të lartë dhe duke siguruar transparencë dhe efikasitet maksimal.

Për këto arritje, në Qershor 2010, sistemi i prokurimit elektronik mori një vlerësim shumë të rëndësishëm, kur Kombet e Bashkuara e renditën Agjencinë e Prokurimit Publik në vendin e dytë në botë për Prokurimin Elektronik duke vlerësuar kontributin e saj drejt përmirësimit, efektivitetit, efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve publike.

## **11. TREGUESIT E VEPRIMTARISË NË DREJTIM TË INTEGRIMIT, MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS**

Duke pasur parasysh:

- Rëndësinë që kanë marrëdhëniet me publikun, sidomos për prokurimet publike në kuadër të transparencës;
- Rëndësinë e madhe që kanë marrë trajnimet për prokurimet publike, në ligjin e prokurimit publik, sipas

të cilit APP është institucioni përgjegjës për organizimin e seminareve dhe trajnimeve në fushën e prokurimit;

- ☛ si dhe detyrimin e përafritit të legjislacionit me Direktivat e BE-së dhe zgjidhjen dhe mbulimin e problemeve që dalin në kuadrin e integritit evropian,

edhe puna në drejtim të menaxhimit të integritit, burimeve njerëzore, dhe financës, ka zënë një pjesë të rëndësishme në aktivitetin e APP-së gjatë vitit 2010.

### **11.1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore**

Gjatë vitit 2010, nisur dhe nga ndryshimet e numrit të punonjësve dhe strukturës së saj, Agjencia e Prokurimit Publik, është përballur me një sfidë në menaxhimin e burimeve njerëzore, pasur parasysh dhe detyrat ligjore që ka APP në fushën e prokurimit, koncesioneve dhe ankandit publik. Me qëllim përshtatjen sa më mirë të detyrave funksionale me strukturën dhe organikën e saj, APP pas shkurtimit të numrit të punonjësve nga 36 në 18, propozoi një strukturë të re për miratim. Sipas kësaj strukture, APP u nda në dy drejtori kryesore; drejtorinë juridike, të monitorimit dhe publikimit dhe drejtorinë e teknologjisë së informacionit. Për shkak të rëndësisë dhe shtrirjes së aplikimit të sistemit të prokurimit elektronik, drejtoria e IT është aktualisht dhe drejtoria më e madhe në numër. Në kuadër të ndryshimeve të sipërpërmendura gjatë vitit 2010 u nxorën në listë pritje 9, persona na të cilët 3 janë shkëputur nga lista pritjes për shkak të rifillimit të marrëdhënieve të punës në administratën publike.

Gjithashtu gjatë këtij viti, në kuadër të ndryshimeve të sipërpërmendura janë rifreskuar të dhënat në regjistrin themeltar të punonjësve dhe janë riparë dhe plotësuar dosjet e çdo punonjësi të APP-së.

Gjatë këtij viti ka ndryshuar dhe Autoriteti Përgjegjës në institucion, i cili ka mbajtur kontaktet me Inspektoriatin e

Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, ku ka raportuar emrat e personave përgjegjës për deklarimin e pasurive si dhe ka dërguar në kohë Deklarimet përkatëse.

## **11.2. Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP-së dhe specialistëve të prokurimit pranë autoriteteve kontraktore**

### **11.2.1. Trajnimet e stafit të APP-së**

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve administrative, gjatë vitit 2010 përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik kanë marrë gjithashtu pjesë në një sërë seminaresh të organizuar brenda dhe jashtë vendit dhe konkretisht si më poshtë:

Gjatë periudhës Janar-Shkurt 2010, punonjësit e Agjencisë së Prokurimit Publik, morën pjesë në disa seminare të organizuara me mbështetjen e SIGMA-s. Në 5-6 Janar punonjësit e APP-së në nivele drejtuese, morën pjesë në një trajnim mbi aftësitë menaxhuese të punonjësve të administratës publike. Gjatë muajit Shkurt 2010, punonjës të APP-së morën pjesë në disa seminare mbi prokurimin në sektorët utilitarë (energji, postë, ujë, transport), si dhe mbi përdorimin e Marrëveshjes Kuadër.

### **11.2.2. Trajnimet e punonjësve të prokurimit pranë autoriteteve kontraktore**

Sic është përmendur dhe në fillim të kësaj analize, në muajin Maj të vitit 2010 APP është ristrukturuar. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, APP ishte në pritje të fillimit projektit Binjakëzimit të përmëndur më sipër në këtë analizë, projekt i cili po për shkak të ristrukturimeve të sipërpërmendura filloi në Nëntor të vitit 2010. Për këto arsye gjatë vitit 2010 numri i trajnimeve të realizuara nga APP me punonjës të autoriteteve kontraktore ishte relativisht i ulët.

Në 22-23 Shkurt 2010, APP-ja në bashkëpunim me SIGMA-n organizoi një trajnim dy ditor me përfaqësues të disa institucioneve kryesore që prokurojnë fonde publike në sektorët utilitarë (energji, postë, ujë, transport), morën mbi prokurimin në sektorët utilitarë dhe përdorimin e Marrëveshjes Kuadër.

Gjatë katër mujorit të parë të vitit 2010, në bashkëpunim me Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike, u realizua një trajnim me punonjës të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky trajnim u fokusua kryesisht në prokurimin elektronik si dhe në rolin e audituesve në këtë sistem.

Gjithashtu në bashkëpunim me projektin e Binjakëzimit, në katër mujorin e fundit të vitit 2010, u hartua plani i punës së këtij projekti ku një rol të rëndësishëm iu dha përgatitjes së një plani trajnimi si dhe trajnimit të një numri të konsiderueshëm të punonjësve të prokurimit publik në të gjithë vendin, gjatë vitit në vijim.

### **11.3. Integrimi**

Gjatë këtij viti, një detyrë mjaft e rëndësishme për Agjencinë e Prokurimit Publik, në kuadër të procesit të Integritit Evropian, ka qënë përgatitja dhe hartimi i përgjigjeve të Pyetësorit të Komisionit Evropian, për Shqipërinë. Ky Pyetësor përmbante një kapitull gjithëpërfshirës pyetjesh për fushën e prokurimit publik, si në drejtim të kuadrit legjislativ ashtu edhe atij institucional.

Për hartimin e përgjigjeve u angazhua maksimalisht i gjithë stafi i APP-së, me qëllim përgatitjen e tyre me cilësinë e kërkuar dhe brenda afatit kohor të përcaktuar, angazhim që u realizua me sukses.

Gjithsej për fushën e prokurimit publik ishin 22 (njëzetë dy) pyetje, ndërkohë që Agjencia e Prokurimit Publik ishte gjithashtu pjesë e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për t'u

dhënë përgjigje pyetjeve nga kapituj të tjerë të Pyetësorit për sektorë të ndryshëm, që lidhen me fushën e prokurimit publik.

Në kuadër të Integritit, një ndër detyrat vjetore të institucionit është edhe rishikimi dhe paraqitja e prioriteteve për prokurimin publik në bazë të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Këto prioritete përditësohen çdo vit në përputhje me detyrimet e marra me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, dhe dërgohen pranë Ministrisë së Integritit.

Gjithashtu, APP ka përgatitur dhe dërguar pranë Ministrisë së Integritit raporte periodike në lidhje me progresin e arritur, si në drejtim të masave të marra për përafrimin e kuadrit ligjor në përputhje me Direktivat respektive të Bashkimit Evropian, ashtu edhe në drejtim të ngritjes së kapaciteteve institucionale.

Në përmbushje të këtyre detyrimeve, të marra në kuadër të MSA-së dhe dokumenteve të tjerë strategjike të procesit të integritit, Agjencia e Prokurimit Publik do të asistohet edhe nga projekti i binjakëzimit me titull “Mbështetje për forcimin e sistemit Shqiptar për prokurimin publik, koncesioneve dhe ankandit publik”, të Programit IPA 2008. Ky projekt, i cili ka filluar zbatimin në muajin Nëntor, ndër të tjera do të ndërmarrë një krahasim të legjislacionit aktual Shqiptar në fushat e lartpërmendura me dispozitat përkatëse të legjislacionit të Bashkimit Evropian, si dhe do të japë rekomandime për përafrim të mëtejshëm të tij me praktikën më të mira Evropiane.

### **11.3.1. Përfaqësimi i stafit të APP-së në takime dhe forume ndërkombëtare**

Në muajin Shkurt 2010, një përfaqësues i Agjencisë së Prokurimit Publik, zhvilloi një takim dy ditor në Gjenevë mbi draftin e Marrëveshjes mbi prokurimet publike, të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Në muajin Mars 2010 një përfaqësues i Agjencisë së Prokurimit Publik mori pjesë në një takim me përfaqësues të SIGMA-s, vendet e Ballkanit dhe Turqisë si dhe të Bashkimit Evropian, për diskutimin mbi përfundimin e projekt fiches së Projektit me shumë përfitues nga fondet IPA “Trajnimi në prokurimet publike në vendet e Ballkanit dhe Turqi”.

Ne muajin prill, dy përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik kanë marrë pjesë në Forumin Rajonal për Prokurimet Publike, organizuar në Stamboll nga Banka Botërore dhe Banka Aziatike. Në këtë Forum, ndërmjet të tjerash, u bë një prezantim i sistemit të prokurimit në vendin tonë, arritjet dhe objektivat për të ardhmen.

Në muajin Qershor 2010, përfaqësues nga APP-ja morën pjesë në Konferencën Rajonale ‘Mbi sistemin e prokurimit publik’. Në këtë konferencë marrnin pjesë përfaqësues nga të gjitha vendet e Ballkanit. Pasur parasysh tematikën dhe pjesëmarrjen, Konferenca shërbeu jo vetëm për prezantimin risive në fushën e prokurimit në secilin nga vendet përfaqësuese, por gjithashtu dhe për shkëmbimin e eksperiencave me homologët e vendeve të rajonit, në këtë drejtim. Shkëmbimi i eksperiencave me vendet e rajonit është shumë i rëndësishëm, pasi të gjitha këto vende, përfshi këtu dhe Shqipërinë kanë të njëjtën problematikë në fushën e prokurimeve.

Gjithashtu, mbi reformat e deritanishme në fushën e prokurimit publik, sfidat kryesore dhe prioritetet në vazhdim, u zhvillua në Nëntor Forumi dy-ditor për Prokurimin Publik, organizuar nga OECD/SIGMA, në Paris, Francë. Në këtë forum, gjatë të cilit APP u përfaqësua nga 3 (tre) punonjës të saj, u bë një prezantim dhe u diskutua mbi situatën aktuale të Shqipërisë, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit me direktivat respektive të BE-së, ashtu edhe në drejtim të mirëzbatimit të tij kundrejt forcimit të kapaciteteve administrative. Gjatë këtij eventi, u diskutua edhe mbi planin e veprimit në funksion të përmbushjes së prioritetëve të



përcaktuara në këtë fushë, si dhe bashkëpunimin e huaj dhe asistencën e tyre për realizimin në kohë të këtyre prioritetëve.

Ndërkohë, OECD në bashkëpunim me Sekretariatit e CEFTA-s organizuan në datë 03.10.2010, në Paris, Tryezën e Rrumbullakët për Prokurimin Publik. Në këtë takim, ku mori pjesë një përfaqësues i Agjencisë së Prokurimit Publik, u paraqitën rezultatet e vlerësimit të sistemeve të prokurimit publik të vendeve anëtare të CEFTA-s, në kuadër të raporteve të vitit 2010, të përgatitur nga OECD për këto vende. Gjithashtu, gjatë këtij takimi u diskutua edhe mbi realizimin e detyrimeve të ndërmarra për prokurimin publik, në kuadër të kësaj Marrëveshje, detyrime të cilat në sistemin tonë të prokurimeve janë përmbushur në pajtim me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes në fjalë.

#### **11.4. Gjëndja financiare e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2010**

Agjencia Prokurimit Publik në zbatim të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2010”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore” ka marrë fonde nga buxheti i shtetit, si dhe ka krijuar të ardhura dytësore, nga shitja e Buletinit të Njoftimeve Publike, si më poshtë:

Në 000/lekë						
Nr	Emërtimi	Plani Fillestar	Ndyshimet	Plani Përfund.	Fakti	%
1.	Të ardhurat nga buxheti	98 675	-6 600	92 075	50 197	54.5%
2.	Të ardhura dytësore				1 718	-
	<b>Totali</b>				<b>51 915</b>	

Në buxhetin e miratuar për vitin 2010, APP- së i janë parashikuar në zërin 602 “Mallra e shërbime”, 30.000 000 lekë, dhe në zbatim të ligjit nr. 10310, datë 26.07.2010, në planin e buxhetit të shpenzimeve korente për vitin 2010, për institucionin tonë u bë paksimi i fondeve në vlerën 6 600 000 lekë.

Shpenzimet e përgjithshme të APP-së, në fund të vitit 2010, kanë arritur në rreth 50 197 000 lekë, duke u realizuar 54.5 përqind, ose me nje mosrealizim prej rreth 41 878 000 lekë. Krahasuar me planin vjetor të realizuar, të së njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 73 247 000 lekë më pak ose rreth 40.6 përqind më të ulta, ku peshën kryesore e zë mos botimi i Buletinit të Njoftimeve Publike (për shkak të heqjes së detyrimit për publikimin e tij në formë të shkruar) dhe mos realizimi i shpenzimeve për investime.

Në totalin e shpenzimeve buxhetore të realizuara, gjatë vitit 2010, shpenzimet korente zenë rreth 97 përqind, nga rreth 61.3 përqind të parashikuara, ndërkohë që shpenzimet për investime zenë rreth 3 përqind nga 38.7 përqind të parashikuara.

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve korente, situata e realizimit të tyre në fund të vitit 2010, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

	Emërtimi	Plan 2010	Fakt 2010	Në %
1	Shpenzime paga	27 970	24 155	86.26
2	Sigurime Shoqërore	5 000	3 506	70.00
3	Mallra Shërbime	23 400	20 953	89.54
4	Transferta F.veçantë	30	30	100.00
5	Shpenzime për nvestime	35 675	1 553	4.30
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>92 075</b>	<b>50 197</b>	<b>54.51</b>

Brenda shpenzimeve korente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 49.65 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë vitit 2010, rezultojnë me një mosrealizim prej rreth 3 845 000 lekë, ose rreth 86.26 përqind me parashikimin vjetor. Mosrealizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore erdhi për shkak të ristrukturimit të APP -së më 01 Maj 2010. Fondi i pagave me shtesat i planifikuar për vitin 2010 për 36 punonjës, u përdor për 18 punonjës në organikë, dhe pjesa tjetër e punonjësve të dalë nga ristrukturimi u pagua me listë pritje, duke mos përfituar shtesat për kushte pune dhe kualifikime, dhe njëkohësisht disa prej tyre gjatë vitit ndërprejnë pagesën nga listë pritja.

Shpenzimet operative që përfaqësojnë rreth 43 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë këtij viti, rezultojnë me një kursim prej rreth 2 447 000 lekë.

Ndër zërat kryesorë janë:

- shpenzimet për prodhimin e Buletinit të Njoftimeve Publike në krahasim me vitet etjera që arrinin rreth 10 800 000 lekë, këtë vit u realizuan për 2 407 0000 lekë, pasi nga data 24.05.2010, **BNJP del vetëm në internet.**

- Shpenzimet për shërbim interneti –nga fondi i parashikuar në fillim të vitit, me realizimin e procedurave të prokurimit u kursyhen rreth 1 319 000 lekë.

Gjithashtu edhe disa zëra shpenzimesh nuk u realizuan nga parashikimi, pasi shkurtimi i organikës solli edhe pamjaftueshmërinë me staf për organizimin e trajnimeve me Autoritetet Kontraktore.

Shpenzimet kapitale, janë realizuar 4.3 përqind. Fondi i akorduar nga buxheti në fillim të vitit ishte 35 675 000 lekë.

Investimet nuk u realizuan në zërin blerje paisje kompjuterike, pasi nga specialistët e fushës së teknologjisë së informacionit u bë i mundur studimi i tregut dhe rezultoi se paisjet e kërkuara e tejkalonin vlerën e fondit të përcaktuar për këtë investim. Kapacitetet e kërkuara për Upgrade të sistemit kanë

qenë shumë herë më të mëdha se ato të përcaktuara fillimisht dhe si pasojë edhe kostoja për blerjen e tyre i tejkalonte vlerat e përcaktuara për blerjen e tyre.

Në zërin përmirësim dhe zhvillim për arsye të kalimit në një strukturë më efikase duke i ndryshuar nga 1 server aplikacioni në 3 servera, si dhe nga 1 server për database në 2 servera të tillë, nuk ishte e mundur që me këtë fond ti jepej zgjidhje pjesës së Disaster Recovery.

Të ardhurat e krijuara nga Posta Shqiptare për abonimin dhe shpërndarjen e buletinit deri më 24.05.2010, në vlerën 1 717 000 lekë, janë arkëtuar nga Posta Shqiptare dhe derdhen 100% në buxhetin e shtetit, duke mos patur dhe detyrime të prapambetura nga vitet e kaluara. Detyrimet ndaj të tretëve janë shlyer rregullisht, dhe nuk ka detyrime të pashlyera për vitin 2010.

## **12. MARRËDHËNIET E APP-SË ME TË TRETËT**

Gjatë vitit 2010, përveç komunikimeve shkresore, nëpunësit e APP-së, u kanë dhënë shpjegime dhe këshilla përfaqësuesve të institucioneve dhe në takime të zhvilluara në ambjentet e APP-së. Gjatë këtij viti nëpunësit e APP-së kanë pritur në takime përfaqësues të Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë. Këto takime janë zhvilluar me Drejtorin e Përgjithshëm si dhe me përfaqësues të Drejtorisë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit dhe të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.

## **13. PËRMBYLLJE**

Nga të gjitha të dhënat e pasqyruara në këtë analizë të punës një vjecare të Agjencisë së Prokurimit Publik, vihet re se APP-ja është përballur me një sërë sfidash gjatë vitit 2010. Megjithatë këto sfida nuk kanë penguar arritjen e rezultateve shumë pozitive në fushën e prokurimit publik e sidomos të atij elektronik.

Ndryshimet strukturore që APP-ja pësoi gjatë vitit 2010, si dhe shkurtimi i konsiderueshëm i stafit të APP-së, megjithë heqjen e kompetencës së shqyrtimit të ankesave, u shoqërua me rritje të ngarkesës së punës në APP. Në bazë të legjislacioneve në fuqi të prokurimit publik, koncesioneve si dhe ankandeve, APP ka një rol të rëndësishëm rregullator të fushave të sipërpërmendura.

Rezultatet e arritura megjithë sfidat me të cilat është përballur APP-ja gjatë vitit 2010, pasqyrohen qartë në numrin e ankesave të shqyrtuara deri në muajin Maj 2010, aktet nënligjore të inciuara, udhëzimet e hartuara dhe miratuara në ndihmë të Autoriteteve Kontraktore në punën e tyre të përditshme, numrin e praktikave për dhënien e interpretimeve dhe asistencës ligjore në fushat e veprimit, në numrin e procedurave të prokurimit të publikuara në Buletinin e Njoftimeve Publike, në sigurimin e mbarëvajtjes dhe mirëfunksionimit të sistemit të prokurimit elektronik etj.

Një nga treguesit më të mirë të rezultateve të punës së APP-së ishte dhe cmimi i vendit të dytë në Botë që iu dha nga Kombet e Bashkuara për Shërbime Publike, në kategorinë “Përmirësimi i transparencës, përgjegjshmërisë dhe gadishmërisë në shërbimin publik”. Lehtësirat e krijuara nga përdorimi i sistemit të prokurimit elektronik, si dhe përfitimet e arritura prej tij, janë vlerësuar nga ky çmim si një kontribut shumë i madh në përmirësimin e administratës publike në Shqipëri.

Nga rezultatet e arritura dhe vlerësimi pozitiv i aplikimit të sistemit elektronik, duket qartë se kontributi që APP-ja ka dhënë në drejtim të përmirësimit të administratës publike, ka qënë shumë i madh dhe njëkohësisht shumë i vlefshëm. Ky kontribut është arritur ë sajë të puës së APP-së për mirëfunksionimin e sistemit të prokurimit publik.

Megjithatë puna për mirëmbajtjen e sistemit dhe administrimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme për

aplikimin e një sistemi të tillë nga Autoritetet Kontraktore si dhe përmirësimin e tij të vazhdueshëm, është ende një sfidë me të cilën APP-ja u përballë gjatë vitit 2010 dhe do të vazhdojë të përballë dhe gjatë vitit 2011.

Përpyjekjet e APP-së për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, janë vlerësuar gjithashtu dhe nga Raporti Analitik i Komisionit Evropian për fushën e prokurimit publik, në kuadër të opinionit të Komisionit mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky Raport vlerëson se legjislacioni shqiptar është përafëruar gjerësisht me parimet e përgjithshme të zbatueshme për prokurimin publik në tregun e brendshëm. Po sipas Raportit në fjalë, vlerësohet se krijimi i Komisionit të Prokurimit Publik, kompetent për shqyrtimin e ankesave, siguron ndarje të funksioneve të politikbërjes dhe zbatimit nga ato të rishikimit, duke e sjellë sistemin më afër rregullave të BE-së. Në përgjithësi Raporti vlerëson se Shqipëria ka përmbushur angazhimet e saj në këtë fushë, në kuadër të MSA-së. Kuadri ligjor dhe institucional siguron një bazë të mirë për zhvillimin e një sistemi efektiv të prokurimit publik sipas rregullave të BE-së. Nga ky Raport vlerësohen si të përmbushura detyrat e nxjerra në Progres Raportin e vitit 2009.

Megjithatë Raporti ka evidentuar nevojën e përafërimit të mëtejshëm si dhe sigurimin e zbatimit të tij efektiv në një periudhë afatmesme, vecanërisht në fushat e koncesioneve dhe rishikimit. Gjithashtu sipas raportit duhet të sigurohen kapacitete të mjaftueshme në të gjitha institucionet e prokurimit publik si dhe të përcaktohen qartë dhe të ndahen përgjegjësitë dhe mekanizmat e bashkëpunimit midis këtyre institucioneve

Megjithë progresin dhe arritjet e bëra gjatë vitit 2010, për realizimin e detyrave dhe përmbushjen e mëtejshme të angazhimeve të ndërmarra në fushën e prokurimit publik, pasur në konsideratë dhe ato të nxjerra nga Raporti Analitik, APP -ja ka akoma një sërë prioritesh, për të cilat duhet të punojë në vazhdim. Ndër to si më kryesoret theksojmë,

- Amendimi i legjislacionin të prokurimit publik dhe koncesionit, për përafrimin e mëtejshëm me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian. Kjo detyrë është një sfidë që do realizohet me ndihmën e projektit të Binjakëzimit që do ta asistojë APP-në gjatë vitit 2011;
- Implementimin në praktikë të rregullave të prokurimit në sektorët utilitarë si dhe zbatimin e Marrëveshjes Kuadër nga disa prej Autoriteteve Kontraktore;
- Përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit elektronik;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit, e cila është një sfidë që ngelet gjithmonë e hapur, duke qënë se legjislacioni i prokurimit është në proces të vazhdueshëm ndryshimi. Ngritja e kapaciteteve administrative është një sfidë shumë e rëndësishme me të cilën APP-ja do të përballohet gjatë vitit 2011, për realizimin me sukses të të cilës do të asistohet nga Projekti i Binjakëzimit.